

RENDI I DITËS

Projektvendimin “Për krijimin e KOV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 4383/01, KZAZ 79, Bashkia Tepelenë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini, Z. E. Meta.
- **Parti Politike:** Bashkë Fitojmë (F.Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE/ODIHR

Z. I. Celibashi: Mirdita! Atëhere në seancën e sotme në rend dite kemi:

- Projektvendimin “Për krijimin e qendrës së posaçme të votimit dhe sasinë e fletëve të votimit për këtë qendër, në Bashkinë e Tepelenës”.
- Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 374 ID, 375 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 380 ID, 381 ID, 382 ID, 383 ID, 384 ID, 385 ID, 388 ID, 389 ID dhe nr. 390 ID, të Koalicionit Bashkë Fitojmë, nëpërmjet zotit Ivi Kaso.
- Informacione mbi masat e marra nga policia e shtetit dhe policitë bashkiake për vendimin numër 424, datë 03.05.2023 të Komisionerit shtetëror të zgjedhjeve.
- Raportim mbi informacionet e dërguara nga bashkitë për vendimet për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

- Shqyrtimin administrativ numër 357 të koalicionit Bashkë Fitojmë ndaj Bashkisë Maliq dhe denoncimin numër 358 po të koalicionit Bashkë Fitojmë edhe ky lidhur me veprimtarinë e Bashkisë Maliq. Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. E. Meta: Komisioni i zonës, i administrimit zgjedhor 79, Bashkia Tepelenë, me shkresën 4474 datë 2 maj 2023 i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve krijimin e komisionit të qendrës së votimit të posaçme numër 4383/01, njësi administrative qendër Tepelenë. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar edhe vendimi numër 1 datë 27.04.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, kërkesë për dhënien e së drejtës për të votuar personave të paraburgosur dhe të dënuar që ndodhen aktualisht në I EVP Tepelenë. Të cilët kanë të drejtën e votës po nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve të qendrës së votimit 4383/01. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të autorizojë KZAZ-në 79, Bashkia Tepelenë që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të qendrës së votimit 4383/01 nga qendrat e tjera të votimit të KZAZ-së 79 me procesverbale. Respektivisht të marri 22 fleta votimi për kryetar dhe 22 fletë votimi për këshill nga qendrat e votimit 4391, 4391/01, 4392 dhe qendra e votimit 4394 dhe 4395. Bashkëlidhur projektvendimi për miratim.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike? Dakord, skemi! Mirë, atëhere miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur. Këto janë qendra votimi që ngrihen në vendet e ruajtjes....

Vendim nr. 464

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

**08.05.2023
Ora 12:14**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 374 ID, 375 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 380 ID, 381 ID, 382 ID, 383 ID, 384 ID, 385 ID, 388 ID, 389 ID dhe nr. 390 ID, të Koalicionit Bashkë Fitojmë, nëpërmjet zotit Ivi Kaso”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini,**
- Parti Politike: **s’ka**
- Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëhere, vazhdojmë me pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me denoncimet e paraqitura nga zoti Ivi Kaso.

Znj. M. Koja: Po janë të gjitha denoncimet...

Z. I. Celibashi: I referojmë të gjitha pastaj sipas rastit nëse ka përfaqësues të institucioneve.

Znj. M. Koja: Është denoncimi ndaj Bashkisë Durrës, subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Objekt denoncimi është “Tenderim i milionave eurove për asfalt elektoral e punime të tjera infrastrukturore, abuzim me portin dhe me fondet. Një nga përfitueset është edhe zonja Emirjana Sako përmes bashkisë Durrës”. Kërkojmë nga ana e KQZ-së marrjen e masave të menjëhershme përfshirë dhe sanksionet e

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

parashikuara lidhur me këtë çështje. Janë kërkuar parashtrime Bashkisë Durrës e cila bazon pretendimet e saj në ligjin për “Për vetëqeverisjen vendore” përcaktohen funksionet në fushën e infrastrukturës publike. Bashkia Durrës shprehet se punimet realizohen sipas parashikimeve buxhetore të miratuara nga këshilli bashkiak për çdo sektor. Rikonstruksioni i rrugës “Marseja”, “Napoli” dhe “Hideve” janë kryer nga “Ndërmarrja “Rruga”, me fondet e miratuara nga Këshillit Bashkiak. Ndërsa për sa i përket rrugës “Valbona” në Njësinë Administrative Rrashbull, rikonstruksioni i saj është bërë në vitin 2022. Takimi i zhvilluar me banorët e zonës është një takim në kuadër të fushatës elektorale, por në këtë takim nuk ka asnjë promovim të investimeve të kryera me fonde të planifikuara pas datës 13 janar 2023. Përsa i përket pastrimit të zonës bregdetare nga papastërtitë, sqarojmë se kjo është një punë sistematike që kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh, si një detyrë funksionale dhe intensifikohet më tepër në prag të sezonit turistik. Ky është denoncimi i parë për çështjen e parë që kemi në shqyrtim.

Z. I. Celibashi: I referojmë të gjitha denoncimet dhe pastaj...

Znj. M. Koja: Dakord.

Z. I. Celibashi: Se edhe për denoncuesin e Bashkë Fitojmë është më e leverdisshme kështu. Po!

Znj. M. Koja: Denoncimi tjetër është sërish ndaj Bashkisë Durrës është ndarë në përmbajtje elektorale. Bashkia Durrës dhe zyra vendore e arsimit parauniversitar, Durrës. “Inagurim i shkollës “Dhosi Liperi“ në Sukth, me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë së Durrësit dhe kandidatës për këtë bashki zonja Sako dhe Ministres së

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Arsimit zonja Evis Kushi”. Kjo është një veprimtari e raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 28 Shkurt për në datën 7 Mars. Denoncuesi pretendon që kjo është veprimtari e ndaluar nga Kodi Zgjedhor për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Është një veprimtari publikuar në rrjetet sociale të Ministres zonja Kushi dhe kandidates zonja Sako si dhe gjithashtu në të gjitha mediat lokale e kombëtare. Kemi marrë pretendimet dhe prapësimet e zyrës vendore Durrës e cila shprehet se nuk ka qënë në rolin e organizatores të këtij aktiviteti, po ka qënë pjesëmarrës. Bashkia Durrës shprehet se me rastin e 7 Marsit Kryebashkiakja ka zgjedhur këtë shkollë për të takuar mësues dhe nxenës dhe për t’i uruar. Ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së sipas afateve dhe nuk kemi marrë njoftim nga ky institucion për të mos e zhvilluar. Nga verifikimi ynë, veprimtaria është e raportuar dhe është në përputhje me parashikimet ligjore.

- Denoncimi tjetër është ndaj bashkisë Krujë dhe subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Objekt denoncimi është Bashkia Krujë që shpërndan grante për riparimin e ndërtimeve të banesave të dëmtuara nga tërmeti 3.5 vite pas fatkeqësisë natyrore dhe vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve. Nga ana e Bashkisë Krujë nuk kemi marrë ndonjë sqarim në lidhje me kërkesat dhe pretendimet e denoncuesit. - Denoncimi tjetër është ndaj zyrës vendore të arsimit parauniversitar Librazhd dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste / kandidati Mariglen Disha. Objekti është “Përdorimi në mënyrë të përsëritur i ambjenteve të institucioneve arsimore në Librazhd, për aktivitete të fushatës elektorale. Kandidati i PS për këtë bashki ka urdhëruar hapjen e shkollës dhe përdorimin e ambjenteve për takime elektorale”.

Bashkelidhur është vënë në dispozicion një foto. Denoncuesi pretendon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë dhe sanksionet e parashikuara lidhur me këto veprime. Nga ana e ZVA-së Librazhd nuk kemi marrë ndonjë përgjigje panvarësisht kërkesave të bëra nga ana jonë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

- Denoncimi ndaj Bashkisë Elbasan (postim në llogarinë personale të kandidatit për kryetar bashkie) kundër subjektit zgjedhor Partia Socialiste. Objekt denoncimi është: “Kryetari i bashkisë Elbasan dhe kandidat i Partisë Socialiste për këtë bashki zoti Llatja publikon në rrjetin e tij social Facebook takime dhe promovime siç janë :

1. Bashkë me zonjën Elva Margariti, zotin Damian Gjikhuri, e deputetë të zonës promovojnë nismën e qeverisë për “Bonusin e Rijetësimit” për pronarë e përdorues të objekteve të ndryshme.
2. I pranishëm bashkë me ministren zonjën Kushi dhe zotin Damian Gjikhuri gjatë zhvillimit të një aktiviteti në pallatin e sportit Tomorr Sinani, Elbasan.
3. Promovon projekte infrastrukturore në shkollën Luigj Gurakuqi, Konstandin Kristoforidhi dhe shkollën artistike Onufri, Elbasan.
4. Bashkë me ministren zonjën Bora Muzhaqi dhe nxënës në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional dhe Qendren Rinore Elbasan, prezantojnë kurset e kodimit me mbështetje nga qeveria.
5. Bashkë me Kryeministrin dhe zotin Gjikhuri, zotin Llatja promovon Auto Moto Park Albania.
6. Promovon rritjen e pagave të punonjësve.
7. Bashkë me zotin Gjikhuri promovojnë investime në fabrikën M&M Topuzi KonstruksioneMetalike, Elbasan.

Denoncuesi pretendon se këtë veprimtari, mbështetjen, promovimin apo inagurimin janë të ndaluara për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Në kuadër të hetimit i është kërkuar informacion Ministrisë së Arsimit, duke qenë se një nga denoncimet kishte të bënte me këtë institucion. Ministria e Arsimit lidhur me aktivitetin e zhvilluar në Pallatin e Sportit “Tomor Sinani”, në datën 8 Prill me pjesëmarrjen e Ministres së Arsimit sqaron se ky aktivitet u organizua nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, (KOKSH) në kuadrin e programit “Ekipet

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Sportive” me nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të Qarkut Elbasan. Zonja Evis Kushi ka qenë e ftuar. Aktiviteti ka qenë i hapur për publikun dhe mund të merrte pjesë kushdo që dëshironte. Ministria e Arsimit ndërkohë sqaron se nga ana e saj ka qënë e rregullt në raportimet në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për të tjera subjekte, u është kërkuar informacion, por nuk kemi administruar përgjigje deri më tani.

- Denoncimi tjetër është ndaj Bashkisë Berat. Objekt denoncimi “Është kryetari dhe kandidati i Bashkisë Berat zoti Ervin Demo i cili promovon shtrimin e asfaltit dhe përmirësimin e kushteve të qytetit në kohë fushate“. Nga ana e saj Bashkia Berat thekson se bazuar në ligjin “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Bashkia Berat ka kompetenca dhe detyrime ligjore në lidhje me mirëmbajtjen e sipërfaqjes administrative, që ndodhet nën juridiksionin e saj. Në zbatim të këtyre detyrave që përcakton ligji, Bashkia Berat çdo vit realizon punime në mirëmbajtjen e sipërfaqjes së zonave që ndodhen nën juridiksionin e saj. Punimet për të cilat ju dhe ankesa ka ardhur dhe i referoheni kanë filluar që prej vitit të kaluar dhe vazhduan deri në përfundimin e tyre, duke mos përfshirë aspak ngjyrimet elektorale, apo afate sikundër pretendohet në denoncim. Asfaltimet, në zonat brenda Rajoneve dhe Njësi Administrative janë kryer, nga Bashkia Berat, si çdo vit sipas nevojave që ato paraqesin, ato kanë filluar në muajt e fundit të vitit 2022 dhe kanë vazhduar sipas nevojave, pa pasuar asnjë qëllime të tjera.

- Denoncimi i rradhës për zotën Blendi Gonxhe dhe Partisë Socialiste. “Shpërdorim i taksave të qytetarëve për fushatë elektorale, nga ana e zotit Blendi Gonxhe”, ky është objekt denoncimi. Duke qenë se kemi qenë të paqartë mbi objektin kemi kërkuar shpjegime të mëtjshme denoncuesit për të marrë masat më pas për të vijuar me hetimin, deri tani nuk kemi marrë informacion të mëtjshëm.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

- Denoncimi ndaj Bashkisë Pukë (Promovim investimesh), kundër kandidatit Gjon Gjonaj. “ Promovim i përmirësimit infrastrukturor në fshatin Gojan, Bashkia Pukë”.

Pretendimet e denoncuesit janë të listuara si vijon:

Zoti Gjonaj është i dënuar në Itali për vepër penale dhe i kallëzuar në SPAK thotë Partia Demokratike.

Kodi Zgjedhor e ndalon mbështetjen, promovimin apo inagurimin për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve.

Kërkojmë nga ana e KQZ-së marrjen e masave të menjëhershme përfshirë dhe Sanksionet përkatëse.

Në lidhje me këtë denoncim i është kërkuar informacion denoncuesit, për të na dhënë informacion shtesë për të plotësuar denoncimin, në mënyrë të tillë që KQZ të vijojë me hetimin administrativ. Deri tani nuk kemi marrë ndonjë informacion tjetër.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Durrës, subjekti zgjedhor Partia Socialiste, kandidates zonjës Sako. “Në datën 1 Maj, kandidatja e PS për bashkinë Durrës ka përdorur studentë e nxënës të shkollave 9 vjecare në fushatë elektorale. Aktivitete që i ka postuar edhe në rrjetet e saj sociale” dhe në rastin konkret kërkohet nga Komisioni Zgjedhor i Zgjedhjeve të merren masat, sanksionimet përkatëse. Është kërkuar informacion nga zyra arsimore Durrës dhe nga ana e Bashkisë Durrës. Ne po vazhdojmë relatimin zoti Komisioner se Bashkia Durrës ka ardhur dhe më pas të...

Z. I. Celibashi: Po, po!

Znj. M. Koja: Dakord.

- Denoncimi i rradhës ndaj Bashkisë Vlorë, zyrës vendore arsimore Vlorë-Himare dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe kandidatit zotit Ermal Dredha. Sipas

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

denoncuesit kreu i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë së bashku me arsimtarë e drejtues të arsimit Vlorë zhvilluan një takim elektoral me kandidatin për kreun e bashkisë Vlorë zotin Ermal Dredha. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me:

Ndërsa duhet të ishin duke kryer detyrën e tyre stafi mësimor gjendet në fushatë zgjedhore (nuk kemi informacion për datën dhe orën e aktivitetit).

Të gjithë mësuesit e shkollave të ZVA Vlorë-Himarë, si ata të pranishëm në aktivitet dhe ata që nuk kanë qënë të pranishëm i kanë bërë like aktivitetit, të shtyrë nga presioni për të ruajtur vendin e punës. Edhe pas kërkesës për informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit nuk kemi administruar asnjë përgjigje nga ky institucion.

- Denoncimi ndaj Bashkisë Lezhë, policisë së shtetit, komisarariatit Lezhë. “Punonjës të Policisë së Shtetit janë përfshirë në fushatë elektorale të kandidatit të Partisë Socialiste për bashkinë Lezhë zotit Pjerin Ndreu”. Nga fotot identifikohet zoti Nikoll Doda efektiv policie në komisariatin e Lezhës, familjarisht (i ati gjithashu efektiv policie dhe i vëllai) marrin pjesë në takime elektorale. Policia e shtetit ka sjellë përgjigje përse pretendohet nga denoncuesi dhe ajo pohon se nga verifikimet dhe këqyrja e fotos së dërguar, rezulton se personi në foto ka ngjashmëri me punonjësin e policisë Nikoll Anton Doda, aktualisht me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisariatin e Policisë Kurbin, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Gjatë intervistimit të punonjësit të policisë Nikoll Doda ai deklaroi se personi në foto nuk jam unë po është vëllai im, i cili quhet Julian Anton Doda, i cili nuk është punonjës policie, por ka qënë punonjës i Forcave të Armatosura në Marinën Shëngjin dhe është larguar nga puna për arsye shëndetësore, në Dhjetor të vitit 2022.

Nga verifikimi i fotos nuk rezulton që të jetë shtetasi Anton Preng Doda, aktualisht oficer i patrullës së përgjithshme në Postën e Policisë Shëngjin. Strukturat e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë qenë dhe janë të angazhuara maksimalisht për respektimin e Kodit Zgjedhor, Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator dhe akteve të tjera me karakter normativ lidhur me procesin zgjedhor. I kemi kërkuar informacion dhe Bashkisë Lezhë por nuk është administruar asnjë përgjigje nga ana jonë.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Elbasan. Palë e denoncuar është vetëm Zyra Vendore e Arsimit Elbasan. “Takim i organizuar nga drejtuesit e shkollës në fshatin Pekisht, Elbasan me prindërit e nxënësve të kësaj shkolle me qëllim për tu kërkuar informacion atyre lidhur me ndihmën ekonomike dhe përkrahjen sociale që ata marrin ose jo nga shteti”. Lajm i publikuar edhe të paktën në një media të shkruar (Gazeta Panorama). Denoncuesi pretendon dhe kërkon nga ana e KQZ-së:

Marrja e këtij informacioni është bërë me qëllim përfitimi të votave nga ana e tyre. Ndërmarrje e sanksioneve respektive, sipas rastit. Është kërkuar informacion nga ana jonë Zyrës Vendore Arsimit Elbasan, nuk kemi administruar përgjigje deri më tani.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Tiranë. “ Në datën 25 prill kryetari i bashkisë zoti Erion Veliaj gjatë takimit me qëllim fushatën, me bizneset përgjatë rrugës pranë martenitetit “Mbretëresha Geraldinë” ka hasur kundërshtimin e pronarit të një biznesi. Të nesërmen policia bashkiake ka marrë masën e gjobës për këtë biznes si hakmarrje ndaj sjelljes së pronarit.” Kërkohej nga ana e denoncuesit hetimin e rastit dhe ndalimin e këtyre veprimeve nga ana e Bashkisë Tiranë. Bashkia Tiranë na ka sjellë këtë informacion: Shërbimet e Policisë Bashkiake gjatë kontrollit të territorit, në datë 25 Prill, në Bulevardin “Zogu i Parë”, njësia administrative Nr. 9, kanë konstatuar se subjekti Drita Ruçi, kishte zënë hapsirën publike me çadër, pa leje përkatësenga Bashkia Tiranë. Për sa më sipër, ndaj subjektit në fjalë është marrë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

masë administrative dhe është liruar hapsira e zënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në lidhje me pretendimet e subjektit politik, ju informojmë se pas verifikimeve të bëra ka rezultuar se Kryetari i bashkisë Tiranë nuk ka qenë prezent me datë 25 Prill në Bulevardin “Zogu i Parë”.

- Denoncimi i rradhës është sërish ndaj Bashkisë Tiranë. “Kryetari i Bashkisë Tiranë, zoti Erion Veliaj, me miratimin e Kryeministrit, pak ditë përpara zgjedhjeve miraton 7(shtatë) leje të reja ndërtimi për kulla në Tiranë”. Kërkohet nga ana e KQZ-së marrjen e masave të menjëhershme përfshirë dhe sanksionet e parashikuara lidhur me veprimtarinë e bashkisë Tiranë. Bashkia Tiranë ka dhënë shpjegimet e saj ku pohon se bashkia e Tiranës në përputhje me parashikimet e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit është institucion vendor, ndërsa Këshilli Kombëtar i Territorit është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. Mbledhja objekt denoncimi është një mbledhje e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT). Viojmë hetimin për rastin.

- Denoncimi është ndaj Bashkisë Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Durrës, Partisë Socialiste, kandidates zonja Sako. “Takim elektorale i kandidatës së Partisë Socialiste për bashkinë e Durrësit zonja Sako me pjesëmarrje të gjimnazistëve të shkollës “Naim Frashëri” dhe “Gjergj Kastrioti”. Në fakt kemi idenë që panvarësisht është denoncuesi i ndryshëm bëhet fjalë për të njëjtin rast për të cilin kemi drejtuar edhe në seancën e kaluar, me të tjerë denoncues. Pretendimet e ZVA janë të njëjtat. ZVA Durrës, dhe as drejtoritë e shkollave, në asnjë rast nuk kanë organizuar, apo nuk janë angazhuar në realizimin e veprimtarive me karakter elektorale. Në këtë vijueshmëri ZVA po monitoron respektimin e procesit mësimor dhe frekuentimin e tij nga nxënësit e Institucioneve Arsimore nën juridiksionin e saj. Asnjë pretendim apo ankesë nga mësues apo nxënës nuk rezulton të jetë bërë pranë ZVAP Durrës. Te Bashkia Durrës shprehet se aktiviteti i zhvilluar nuk ka cënuar aspak mbarëvajtjen e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

procesit mësimor. Sipas konfirmimit zyrtar të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, informohemi se shkollat e mesme në qytetin e Durrësit ndjekin një orar mësimor të përcaktuar, ndjekja e rregullt e procesit mësimor është një detyrim dhe nuk ka arsye që ky proces mësimor të pengohet për pjesëmarrje në fushatë elektorale. Pretendimet e parashtruara në denoncim nuk përbëjnë fakte dhe prova që mund të çojnë në shkeljen e Kodit Zgjedhor.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Komiteti i Investimeve Strategjike. “Miratimi i statusit “investitor strategjik” për projektin e investimit “Green House Korça Resort” me anë të Vendimit 29/4 datë 1.2.2023”. Denoncuesi pretendon që miratimi i këtij vendimi është në shkelje të Vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator që ndalon shprehimisht miratimin e investimeve strategjike 4 muaj para zgjedhjeve. Kërkon nga ana e KQZ-së marrjen e masave të menjëhershme përfshirë dhe sanksionet e parashikuara lidhur me këtë vendim. Kemi kërkuar informacion por ende nuk kemi administruar asnjë përgjigje për rastin. Vijon hetimi edhe për këtë rast.

- Denoncimi i rradhës për Bashkia Durrës për Partia Socialiste/kandidati Emirjana Sako, ZVA Durrës. “Kryeministri Edi Rama, Kryetarja e bashkisë Durrës njëherazi Kandidate e PS për këtë bashki dhe ministrja për Rininë Bora Muzhaqi kanë marrë pjesë në takime elektorale në qytetin e Durrësit së bashku me nxënës e staf arsimor. Objekt i këtij aktiviteti ka qenë edhe mbjellja e pemëve në Porto Romano. Zyra Vendore Arsimore Durrës është shprehur se është vënë në dijeni të takimit të përmendur nga rrjetet sociale dhe mediat ajo siguron se nuk ka asnjë përfshirje të institucionit tonë në organizimin e veprimtarisë, sikurse kemi marrë një përgjigje të tillë edhe nga shkollat përkatëse dhe nuk rezultojnë të ketë përfshirje të nxënësve dhe mësuesve në veprimtari elektorale ose jo, brenda procesit mësimor. Nuk rezultojnë të jetë bërë asnjë pretendim apo ankesë nga mësues apo nxënës pranë ZVA Durrës. Dhe Bashkia Durrës ka dhënë pretendimet e saj se ky aktivitet nuk ka cënuar aspak

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ishte vetë stafi drejtues dhe nxënës të shkollës që ftuan kryebashkiaken Emirana Sako për mbjelljen simbolike të disa pemëve me rastin e 20 vjetorit të kësaj shkolle. Ky aktivitet është zhvilluar ditë shtune, pra ditë pushimi. Ndjekja e rregullt e procesit mësimor është një detyrim dhe nuk ka arsye që ky proces mësimor të pengohet për pjesëmarrje në fushatë elektorale. Pretendimet e parashtruara në denoncim nuk përbëjnë fakte dhe prova që mund të çojnë në shkeljen e Kodit Zgjedhor. Por ne nuk gjejmë dot hetimin së për cilën shkollë bëhet fjalë, deri tani nuk na e kanë sqaruar palët. Vijon dhe për këtë çështje hetimi.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Fier. “Punonjësit e bashkisë Fier kushtëzojnë shërbimin kundrejt qytetarëve të cilët paraqiten pranë këtij institucioni publik dhe nuk ofrojnë shërbim ndaj tyre, derisa të ketë konfirmuar statusin pëlqyer (like), për veprimtarinë e publikuar nga kryetari i bashkisë”. Denoncuesi pretendon se pjesëmarrje e administratës publike gjatë orarit të punës në fushatë zgjedhore është në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe kërkojmë nga ana e KQZ-së hetimin e rastit dhe ndalimin e këtyre veprimeve të ndaluara nga punonjësit e Bashkisë Fier. Kemi kërkuar informacion por deri më tani nuk kemi administruar përgjigje nga ana e Bashkisë Fier.

- Denoncimi i rradhës është ndaj Bashkisë Maliq. “Pjesëmarrja e administratës së bashkisë Maliq në takimin elektoral të kryeministrit Rama në këtë qytet në datën 2 Maj në orën 14:30“. Denoncuesi pretendon se gjatë orarit të punës në fushatë zgjedhore është në shkelje të Kodit Zgjedhor. Kanë verifikuar dhe na janë venë në dispozicion emrat dhe funksionin e secilit prej punonjësve pjesëmarrës në këtë aktivitet elektoral. Administrator Libonik, nën kryetari bashkisë, administrator Pojan, agronom, janë disa punonjës bashkie dhe kërkojnë nga ana e KQZ-së hetimin e rastit dhe ndalimin e këtyre aktiviteteve të ndaluara dhe që ushtrohen nga Bashkia Maliq. Bashkia Maliq na ka informuar se nga 8 (tetë) personat e listuar nga denoncuesi

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

7(shtatë) prej tyre janë punonjës të bashkisë Maliq, ndërsa një nuk është punonjëse e kësaj bashkie. Përsa i përket disa punonjësve të tjerë (nuk po përmendin emrat deri në shpalljen e vendimit) janë administratore dhe nën kryetarë dhe janë funksionar politik që emërohen dhe shkarkohen nga vetë kryetari i bashkisë sipas ligjit “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ushtrojnë funksione në bazë të vendimarrjes së tij dhe nuk kryejnë funksione publike. Funksionarët politikë në ndryshim nga punonjësit e administratës shtetërore janë pjesë e aktivitetit politik që zhvillon kryetari i bashkisë.

- Përsa i përket disa punonjësve të tjerë Bashkia Maliq, sqaron se ata janë me leje vjetore. Sipas kërkesave të tyre të miratuara nga epërorët në datën 28 prill dhe bashkëlidhur kanë sjellë kopjet e njëhsuara gati për lejen vjetore të miratuar për këta punonjës. Ndërsa përsa i përket agronomit, bashkia shprehet se nuk ka qenë pjesë e mitingut, është thjesht një foto e personit në fjalë duke ecur në rrugë. Duke qenë se nga karakteri i punës së tij ai është në terren, është thjesht një foto e marrë në terrën nga ky person dhe nuk ka qenë pjesëmarrës në fushatën elektorale. Me këtë rast përfundojmë shqyrtimin për denoncimet që janë në rendin e ditës për sot.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, i japim fjalën përfaqësuesit të koalicionit Bashkë Fitojmë nëse kanë ndonjë shtesë ose koment për këto çështje ose në përgjithësi për këto.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësuesi i BF: Po, faleminderit zoti Celibashi, atëhere falenderojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për paraqitjen e gjithë denoncimeve sot. Aty te relatimi vura re që kishit një mungesë informacioni në mos gaboj, për rastin e zotit Blendi Gonxhe. Në denoncimin tonë janë paraqitur gjithë elementët të mjaftueshëm për të iniciuar porçedimi administrativ, megjithatë sqaroj në shtesë të kesaj, që bëhet fjalë, ndër të tjera, për aktivitetin e krijuar nga, e zhvilluar nga Retro.al, që është nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, pikërisht në administrim nga zoti Gonxhe, për aktivitetin që Retro.al ka zhvilluar në Dibër përpara gjashtë dithësh. Është një aktivitet i publikuar gjërisht edhe në rrjete sociale të vet kësaj faqeje, po themi, që varet nga drejtoria e zotit Gonxhe dhe problematike aty, i nderuar zoti Komisioner është fakti se ka qënë pjesëmarrëse zonja Balluku, në cilësinë e ministres patjetër, por dhe në cilësinë, dihet që në Dibër është ajo që drejton fushatën e Partisë Socialiste, dhe nuk është thjeshtë koeçidencë, nga informacionet që ne kemi, nga informacionet që kemi marr, eventin nuk ka qënë i planifikuar për t'u bërë normalisht në këtë periudhë, por është avancuar si datë, dhe ne gjykojmë që kjo është bërë kastile për ta shfrytëzuar eventin për qëllime elektorale. Dihet që ka kryeqyteti mungesë të theksuar aktivitetesh dhe eventesh kulturore, jo më Dibra, që pothuajse nuk ka fare, në gjykimin tonë, kështu që një event i tillë i madh për atë zonë ka krijuar patjetër që popullaritet dhe është shfrytëzuar politikisht në gjykimin tonë, kështu që kjo është ajo që desha të shtojë në lidhje me çështjen Blendi Gonxhes dhe Retro.al. Patjetër që ata kanë kryer aktivitet dhe në Tiranë të sheshi Skënderbej, por pikërisht kjo e Dibrës ishte me pjesëmarrjen e ministres që është njëkohësisht edhe drejtuesja politike e qarkut, po themi, për zgjedhjet nga PArtia Socialiste, këtë kisha për të thënë për pjesën e Dibrës. Pastaj për në përgjithësi, pa hyrë në detaje të tjera ne kemi, zoti Komisioner, edhe shqetësimin e Fierit, që mora shkas nga ajo çka u relatua për punonjësen e Bashkisë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Fier, që ishte në orarin e punës dhe nuk jepte shërbimin, kjo është e filmuar, e dhënë në media, nuk jepte shërbimin ndaj qytetarëve përse kohë nuk kishte mbaruar së dhëni 'like' postimeve të kryetarit të bashkisë, dhe kjo vjen në vazhden e denoncimeve që ne kemi bërë si opozitë për aktivistin, për patronazhistin 2.0 domethënë që është versioni i sofistikuar i patronazhistit, ku punonjësit e administratës në mbarë vëndin detyrohen në një mënyrë ose në një tjetër, që jo vetëm t'i japin pëlqime dhe të shpërndajnë postime politike jashtë orarit të punës, por dhe brenda orarit të punës, sikurse ka ndodhur në rastin konkret, kjo gjë është vërtetuar se ka ndodhur, sepse ishin filmimet përkatëse dhe qytetarët që prisnin për të marr shërbimin. Ndërkohë me rastin e Fierit, përfitoj nga rasti t'i kërkoj dhe KQZ-së për të pyetur së çfarë ka ndodhur, a kanë ardhur përgjigje apo jo, me rastin e zonjës Bufi, që ishte në Bashkinë e Roskovecit, një denoncim po ashtu i bërë mediatik, të shtunën në mos gaboj u tha se doo të kërkohej informacion nga të gjitha palët, kështu që do kërkoja nga KQZ-ja që të dimim nëse kanë ardhur informacione, përgjigje zyrtare, nga Bashkia Roskovecit nga zonja Bufi, sesi qëndron situata sipas saj, në lidhje me intimidimet, kërcënimet apo shantazhet e kryera publikisht ndaj një punonjësi të bashkisë, vetëm për faktin se ai kishte marr pjesë në një aktivitet elektorale të zotit Sali Berisha. Dhe në përfundim kisha dhe një shqetësim, i nderuar zoti Celibashi, për posterat, që fatkeqësisht ne konstatojmë që nuk janë hequr, në të gjithë rrugët e Shqipërisë, autostradat apo dhe në qytetet e Shqipërisë, posterat e paligjshëm, posterat që bien në kundërshtim më udhëzimet e vet institucionit tuaj, panvarësisht se ju e keni marr këtë masë, panvarësisht se keni dhënë urdhër Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për të evidentuar rastet për t'i hequr dhe për të marr masat, ne konstatojmë se jo vetëm që nuk janë hequr një pjesë, por edhe janë shtuar përsëri postera të tjerë të paligjshme. Kështu që do kërkoja nga KQZ-ja në përfundim të kësaj mbledhjeje të na jepte një raport në lidhje me ecurinë e heqjes së këtyre

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

posterave të paligjshëm, dhe ku jemi masat administrative ndaj shkelësve të ligjit.
Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! E kemi në rendin e ditës informacionin mbi zbatimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror për rastet e vendosjes së materialeve propagandistike në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akte ligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Atëhere shoh që kanë ardhur përfaqësues të disa institucioneve, të cilët kanë qënë në, u referuan në materialin më parë ndërtuar mbi denoncimet e subjektit zgjedhor Bashkë Fitojmë. Sipas rradhës fillojmë ju lutem prezantimin, emër, mbiemër dhe cilin institucion përfaqësoni dhe vazhdojmë.

Përfaqësuesi Bashkisë Durrës: Vangjel Manushi, përfaqësues i Bashkisë Durrës, i kandidates Emiriana Sako. Lidhur me denoncimet e ardhura pranë jush, ne shkurtimisht i kemi përmbledhur në një informacion dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vazhdojmë t'i qëndrojmë pretendimeve tona që këto aktivitete janë brenda kornizës ligjore duke respektuar afatet e njoftimit dhe procedurat. Lidhur me investimet publike, sqarojmë që të gjithë investimet që kanë të bëjnë me rehabilitimin, mirëmbajtjen e rrugës, sinjalistikën rrugore, trotualet, sheshet vendore, janë të gjitha në zbatim të funksioneve të Bashkisë Durrës, duke respektuar Kodin Zgjedhor, janë në fokusin e investimeve që kanë të bëjnë me realizimin e buxhetit Bashkisë Durrës, miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr. 150, 22.12.2022. Konkretisht për rrugët e pretenduara që janë Marseja Napoli dhe rruga e Hideve, përse i përket rrugës Valbona, ne thamë që kjo rrugë është e një investimi të 2022 dhe nuk ka të bëjë fare me këtë . Lidhur me papastërtië bregdetare Bashkia Durrës nëpërmjet ndërmarrjeve ka administruar vazhdimisht pastrimin e tyre dhe është një proces që fillon gjithmonë në pranëverë dhe përgatitet për sezonin turistik.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Përsa i përket pretendimeve lidhur me denoncimet të grupuara 45/63 dhe 45/64 janë aktivitete që janë raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke rëspektuar afatet, nuk janë aktivitete politike, janë thjesht takime me nxënësit e shkollave dhe arsimtarët me rastin e 7 marsit si një aktivitet festiv. Përsa i përket denoncimeve lidhur me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesëve të shkollës Gjergj Kastrioti sqarojmë se këto kanë qënë jashtë orarit mësimor, kanë qënë aktivitete që janë zhvilluar jashtë ambienteve publike, jashtë shkollave. Pretendimet e parashtruara në këtë denoncime nuk përbëjnë fakte dhe prova të cilat shkojnë në shkelje të dispozitave ligjore. Përsa i përket mbjelljes së pemëve ka qënë një aktivitet i organizuar nga shkolla Migjeni, që edhe ju nuk e kishit informacionin e saktë për cilën shkollë bëhej fjalë. Shkolla Migjeni ka patur 20 vjetorin e ngritjes së saj dhe në shenjë simbolike ka mbjellë disa pemë dhe ka ftuar kryetarin e bashkisë ose kandidatin për kryetar bashkie të marri pjesë në këtë aktivitet. Kaq kisha, ju falenderojmë për vëmëndjen.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Mirë atëhere vazhdojmë me institucione të tjera por përpara së të vazhdojmë dua që t'i uroj mirëseardhjen një grupi nxënësish dhe studentësh nëse nuk gabo, nga Mali i Zi. Po vazhdojmë.

Përfaqësuesi AIDA: Përshëndetje, unë jam Enkeled Lamaj dhe përfaqësoj Agjensinë Shqipëtare të Zhvillimit të Investimeve. Kemi marr një denoncim në lidhje me një vendim të marr nga Komiteti i Investimeve Strategjike (AIDA), duhet tju shpjegoj paraprakisht se AIDA luan rrolin e sekretariatit teknik të KIS-it, pra të Komitetit të Investimeve Strategjike, për këtë arsye jemi këtu për të përfaqësuar ose më saktë për të dhënë shpjegimet tona në lidhje me këtë denoncim. Mendojmë që denoncimi nuk është i drejtë, nuk është i bazuar as në ligj, denoncuesi i referohet

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

konkretisht pikës 1.1 dhe gërma ç, duke iu referuar sikur kjo pikë ose kjo normë ndalon miratimin e një vendimi të Komitetit të Investimeve Strategjike, në fakt nuk është kështu, ne mendojmë që ajo që ndalohet, pra që quhet veprimtari publike e ndaluar ka të bëjë me promovimin, pra një aktivitet publik që do të shfaqet në media, në gazetë edhe në portale online, kurse miratimi i një vendimi nga KIS-i Komiteti Investimeve Strategjike, është një procedurë normale, rutinë, e bazuar në ligjin për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë i ndryshura dhe në aktet normative të dala në dhe për zbatim të tij. Këto norma parashikojnë disa procedura specifike që kanë të bëjnë me aplikimin pra me mënyrën sesi aplikojnë subjektet e interesuara, ka norma proceduriale specifike mbi afatet se sa kohë duhet shqyrtuar ky aplikim dhe më pas dhe me marrjen e vendimit nga Komiteti Investimeve Strategjike qoftë në rastet pozitive apo negative, pra kur pranohet apo nuk pranohet ky projekt. Në rasti konkret vetëm kjo ka ndodhur, në asnjë rast nuk ka patur një promovim publik, apo një aktivitet publik as nga AIDA jo e jo që nuk e bën kurrë po as nga, në dijeninë time as nga ndonjë institucion tjetër, kështu që në këtë aspekt edhe vendimi i KQZ-së nr. 9 nuk flet për mosushtrim, në rastin konkret flasim për një ushtrim të funksioneve dhe të detyrave të ngarkuara nga ligji për një institucion, dhë nuk flet për ndalimin e ushtrimit të atij funksioni, por flet për, domethënë fryma në tërësi e vendimit ka të bëjë gjithmonë me promovimin me aktivitetet dhe me aktivitetet publike. Në këtë aspekt i referohemi dhe shkresës tuaj të datës 11.01.2023 me nr.138 protokollit, në pikën 2 të të cilit saktësohet shprehimisht që veprimtaria është publike kur ajo do të pasqyrohet sipas rastit në media, televizione, shtyp etj. Kjo gjë nuk ka ndodhur dhe në këtë aspekt vendimi i Komiteti Investimeve Strategjike nuk është mbështetur dhe nuk është promovuar në publik në asnjë rast në mënyrë që të konsiderohet si veprimtari publike. Në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, dhe as si veprimtari e ndaluar për tu promovuar në kuptim të pikës 1, të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

nenit 1.1, vendimit të KQZ-së numër 9, datë 24.12. Për këtë arsye AIDA nuk ak patur as detyrimin për të njoftuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas përcaktimeve të vendimit numër 9. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, me pak fjalë ju jeni duke thënë që aktet për të cilat janë bërë denoncimet nga subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë, janë pjesë e veprimtarisë të përditëshme të këtij institucioni dhe si të tilla nuk kanë qënë në detyrimin për t'u njoftuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për më tepër nuk janë promovuar ose publikuar nga ana juaj. Pak a shumë kjo ishte?

Përfaqësuesi AIDA: Po, këtë jam duke thënë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, institucione të tjera prezent? Po.

Znj. M. Roms, përfaqësues i MAS: Përhëndetje, jam përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përsa i përket denoncimit me numër ID 375 të paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku në aktivitetet e pasqyruara në rrjete sociale nga kryetari i Bashkisë së Elbasanit në datën 8.04.2023 paraqitet Ministrja e Arsimit dhe Sportit zonja Evis Kushi, e cila ka marr pjesë në aktivitetin e zhvilluar në pallatin e sportit Tomorr Sinani në Elbasan. Sqarojmë se ky aktivitet nuk është organizuar nga Ministria Arsimit dhe Sportit por nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar në kuadër të programit 'ekipet sportive', dhe Ministrja e Arsimit zonja Evis Kushi, ka qënë e ftuar në këtë aktivitet i cili ndër të tjera ka qënë dhe i hapur për publikun. Gjithashtu theksojmë që vijim Ministria Arsimit dhe Sportit ka raportuar në KQZ çdo aktivitet që është organizuar nga ky institucion gjatë periudhës parazgjedhore.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Znj. R. Duraku, përfaqësuese ZVA Elbasan: Romina Duraku, përfaqësuese e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan. Në përgjigje të denoncimit të ardhur nga Partia Demokratike ju informojmë se aktiviteti i vetëm i organizuar nga shkollat nën juridiksionin e Zyrës Arsimore Elbasan është panairi ‘Ditë e Verës’, aktivitet i zhvilluar në datë 9 mars nga shkollat në kuadër të nismës ‘Shkollat qendër komunitare’. ‘Shkollat qendër komunitare’ është një model promovues zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet. Ky aktivitet është raportuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet personit përgjegjës të këtij institucioni në datë 2 mars 2023, gjithashtu ky aktivitet është një aktivitet social-kulturor dhe jo politik, dhe gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka patur fjalime me përmbajtje politike, në favor të një subjekti apo kandidati politik. Pak më parë këtu u njoha dhe për një denoncim tjetër të ardhur për Zyrën Vendore Arsimore Elbasan, për një shkollë në fshatin Pekisht, kjo shkollë nuk është shkollë nën juridiksionin e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, institucione të tjera prezente, nuk kemi. Mirë faleminderit! Atëhere, për të gjitha këto denoncime do të shprehemi me vendimmarrjen përkatëse në një nga ditët në vijim, ndoshta ditën e mërkurë ose ditën e enjte, ndërkohë gjatë këtyre dy ditëve nese do të jetë nevoja do të administrojmë edhe shpjegime të institucioneve të denoncuara, nëse do t'i sjellin brenda kësaj periudhe. Mirë, përfundojmë këtu me këtë çështje.


*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

email Policinë e Shtetit dhe Policitë Bashkiake lidhur me vendimmarrjen për zbatim dhe ndjekje të vendimit. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ecurinë e zbatimit të vendimit, janë ngritur grupe pune në drejtimin e drejtuesëve të DVP-ve dhe komisariateve të policisë me përfaqësues të strukturave të rendit publik të cilat kanë bashkëpunuar dhe bshkërenduar punën me strukturat e Policisë Bashkiake për të ushtruar kontrollin në qendra urbane, sheshe, rrugëkalime për publikim dhe ambiente të tjera në zonat rurale. Gjithashtu informacioni që Policia e Shtetit ka sjellë për zbatim të këtij vendimi referojnë se për Qarqet Berat, Gjirokastrë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier dhe Dibër nuk janë konstatuar shkelje dhe mosrespektim të kërkesave të parashikuara në nenin 79 të Kodit Zgjedhor. Për Qarkun Lezhë është identifikuar në qytetin e Rrëshenit një material propagandistik i cili është hequr nga punonjësit e Policisë Bashkiake. Për Qarkun Vlorë, në fshatin Lukovë, Bashkia Himarë, konstatohen materiale propagandistike të cilat janë hequr nga punonjësit e Policisë Bashkiake. Në Qarkun Kukës, janë konstatuar 4 banderola të subjektit zgjedhor PS të cilat nuk përmbanin shënimin ‘Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...’ dhe të ilat janë hequr, të katërta këto materiale propagandistike. Për Qarkun Korçë, në Bashkinë Pogradec, janë konstatuar 3 materiale propagandistike të afishuara në fshatrat Buçimas, Gurras dhe Çirav, janë marr masa për heqjen e tyre, ndërsa në rastin në qytetin Pogradec, nuk është bërë e mundur heqja e një materiali propagandistik pasi është vendosur pas xhamit të derës së një objekti privat dhe personi nuk ndodhej në objekt, janë marr masa për të kontaktuar personin përgjegjës dhe heqjen e këtij poster. Në Bashkinë Pustec janë hequr materiale propagandistike të afishuara në tre raste, nga të cilat dy në fshatin Pustec dhe një në fshatin Kallamas. Në një rast në qytetin e Bilishtit Bashkia Devoll janë konstatuar materiale propagandistike të cilat janë hequr njëhere por janë rivendosur sërish. Për Qarkun

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

Tiranë, në Bashkinë Tiranë, janë evidentuar gjithësej 22 materiale propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Për Bashkinë Vorë, janë evidentuar 8 materiale propagandistike, në tabela reklamuese përgjatë autostradës Tiranë-Vorë-Maminas. Për Bashkinë Kavajë janë evidentuar 2 materiale propagandistike të cilat janë konstatuar në dy subjekte private, përkatësisht në Qerret dhe Kavajë. Nga koordinimi i punës me Policinë Bashkiake dhe komunikimi verbal me drejtuesit e subjekteve zgjedhore, Policia e Shtetit na informon se do të garantojë, se deri më tani është garantuar nga këto subjekte një reflektim për zbatimin e vendimit nr. 424 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur në materialet propagandistike shënimin 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligore të...' dhe më pas vijon emri i subjektit ose duke i hequr ato nga vendet të cilat nuk e kanë pasur këtë shënim. Strukturat e policisë të DVP-së Tiranë po vijojnë koordinimin e punës me Policinë Bashkiake për heqjen e materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me ligjin të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Lidhur me informacionin e dërguar nga Policia Bashkiake kemi informacion të dërguar nga Policia Bashkiake Tiranë, Shijak, Dimal dhe Kurbin. Përsa i përket Policisë Bashkiake Tiranë, Policia Bashkiake është mobilizuar për verifikimin në terren dhe zbatimin e kërkesave të parashikuara në këtë vendim, i ka dërguar shkresë me lëndë kërkesë për bashkëpunim subjekteve të cilat kanë vendosur këto materiale propagandistike, gjithashtu specifikohet në informacionin e dërguar së nga shërbimet e Policisë Bashkiake Tiranë janë kryer verifikime në terren dhe janë marr masa përkatëse në rast se janë konstatuar shkelje të detyrimeve ligjore në fuqi të kryera nga qytetar apo subjekte zgjedhore. Për Bashkinë Shijak, inspektorët e Policisë së Bashkisë Shijak në bashkëpunim me inspektorët e Komisarariatit të Policisë Shijak kanë ushtruar kontrolle në territorin e kësaj bashkie dhe nuk kanë konstatuar asnjë material propagandistik i cili nuk përmban këtë shënim. Bashkia Dimal njofton se pasi ka marr njoftimin, pra pasi ka

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

marr njoftimin për vendimin numër 424, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të marr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, verifikimin e gjëndjes faktike dhe ndalimin e afishimit të materialeve propagandistike. Bashkia Kurbin ka kryer verifikimet në terren në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe nuk rezulton të ketë materiale propagandistike pa shënimin përkatës. Ky është informacioni që ka sjellë Policia e Shtetit dhe Policinë Bashkiake.

Z. I. Celibashi: Dakord!

Vendimi nr. 465

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

08.05.2023
Ora 13.03

RENDI I DITËS

Raportim mbi informacionin e dërguar nga Bashkitë për vendimin për pëcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet pwr organet e qeverisjes vendore të datpwr organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, V. Ballgjini**
Z. E. Meta, M. Koja
- **OJQ:** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Po për bashkitë të cilat akoma nuk e kanë sjellë vendimin..

Znj. V. Ballgjini: Të gjitha bashkitë e tjera nuk kanë kther përgjigje lidhur me çfarë, pra për të na sjellë informacion se deri ku kanë ecur me zbatimin e vendimit. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar 48 vendime nga bashkitë për përcaktimin e vendeve të publikimit në territorin e bashkive për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Shkurtimisht janë vetëm 13 bashki të cilat nuk e kanë depozituar vëndin e lejuar për afishimin, pra nuk kanë vendim, nuk kanë sjellë as në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve asnjë vendim të kryetarit të bashkisë ku përcaktohet vendi i

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

lejuar për afishimin e materialeve propagandistike. 13 bashkitë janë: Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Cërrik, Bashkia Kukës, Bashkia Delvinë, Bashkia Has, Bashkia Libohovë, Bashkia Shijak, Bashkia Vorë, Bashkia Kuçovë, Bashkia Shkodër, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Devoll dhe Bashkia Divjakë.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë, atëhere për bashkitë të cilat nuk kanë sjell vendimin, nuk kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin që cakton vendet për afishimin e materialeve propagandistike, si dhe për drejtuesit e Policive Bashkiake që nuk kanë sjellë këtë informacion në komisionin Qendror të Zgjedhjeve do të ketë sanksion administrativ, në të dyja rastet.

Vendimi nr. 466

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.05.2023*

ky vendim nuk ka sjellë pasoja juridike dhe nuk është i zbatueshëm. Këto janë pretendimet e Bashkisë Maliq, ndërsa përsa i përket vendimit numër 37 në lidhje me dhënien me qera të pasurisë së paluajtshme në fshatin Vloçisht, në njësinë administrative Libonik dhe fshatin Sovjan njësi administrative Pirg, Bashkia Maliq argumenton se vendimet e mësipërme të këshillit bashkiak janë miratim në parim për nisjen e procedurave për dhënien me qera të këtyre pasurive të cilat do të nënshtrohen procedurave të konkurimit sipas legjislacionit në fuqi dhe më pas do të lidhet kontrata e qerasë me subjektin fitues. Ata theksojnë se nga ana e Bashkisë Maliq ende nuk ka nisur procedura për dhënien me qera të pasurive të miratuara me vendimet e mësipërme.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Kemi ndonjë shtesë nga përfaqësuesi Bashkë Fitojmë?

Përfaqësuesi BF: Jo zoti Komisioner, ne i qëndrojmë ankimeve dhe gjykojmë se janë të gjitha elementët janë të përfshira në ankimimet përkatëse dhe janë të mjaftueshme për vazhdimin e procedurave administrative pranë KQZ-së. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. Atëhere edhe për këto dy denoncime do të shprehemi me vendim në ditët në vijim. E konsiderojmë të përfunduar hetimin administrativ dhe vendimin do ta shpallim në një nga ditët në vijim, dakord. Çështje të tjera në rend dite? Nuk kemi. Mirë faleminderit, seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

